



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

RAPORTI VJETOR I MONITORIMIT TË SBZHR 2022-28

Raporti i monitorimit 2022

PERMBAJTJA:

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	3
2. PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE	6
2.1 PROGRES KUNDREJT OBJEKTIVIT	6
Objekti specifik 1.1: Mbështetje për të ardhura të qëndrueshme të fermës dhe fleksibiliteti për të rritur sigurinë ushqimore.....	6
Objekti specifik 1.2: Rritja e konkurrencës dhe përmirësimi i orientimit ndaj kërkesave të tregut duke u fokusuar në kërkime, inovacion, teknologji dhe digjitalizim.....	8
Objekti specifik 1.3: Përmirësimi i pozitës së fermerëve në zinxhirin e vlerës.....	10
2.1.2 Objekti Strategjik 2: Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore	10
Objekti specifik 2.1: Mbështetje në zbutjen dhe në përshtatjen në ndryshime klimatike, si dhe energjinë e ripërtëritshme.....	10
Objekti specifik 2.2: Mbështetje në nxitjen e menaxhimit të qëndrueshëm dhe efikas të tokës, ujit dhe ajrit.....	11
Objekti specifik 2.3: Mbështetje në mbrojtjen e biodiversitetit, shërbimet e zgjeruara të ekosistemit dhe ruajtja e habitateve dhe peizazheve.....	12
2.1.3 Objekti Strategjik 3: Mbështetje për bizneset në zonat rurale, rritjen e punësimit dhe përmirësimin e infrastrukturës sociale	12
Objekti specifik 3.1: Promovimi i punësimit, rritjes, përfshirjes sociale dhe zhvillimit lokal në zonat rurale, përfshirë bio-ekonominë dhe zhvillimi i qëndrueshëm i pylltarisë.....	12
Objekti specifik 3.2: Përmirësimi i kërkesave shoqërore për ushqimin dhe shëndetin, përfshirë ushqimin e sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm, zvogëlimin e mbeturinave të ushqimit, si dhe mirëqenien e kafshëve.....	13
Objekti specifik 3.4: Promovimi i barazisë gjinore, duke përfshirë pjesëmarrjen e grave në bujqësi dhe përfshirjen sociale të komuniteteve dhe grupeve të cënueshme	13
2.1.4 Objekti Strategjik 4: Reforma gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale për të krijuar shërbime publike efektive	15
Objekti specifik 4.1: Riorganizimi dhe funksionalizimi i plotë i AZHB-së si Agjenci IPARD ..	15
Objekti specifik 4.2: Arritja e besueshmërisë për menaxhim dhe zbatim të buxhetit për masat e programi.....	16
Objekti horizontal 4.3: Digjitalizimi i sektorit dhe transferimi i njohurive.....	16
2.2.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore, duke përdorur tregues dhe grafikë.....	17
2.2.2 Histori suksesit.....	17
2.2.3 Vlerësimin e sfidave, mangësive dhe pengesave	17
2.2.4 Resurset buxhetore	17

2.2.5 Konkluzionet dhe rekomandimet për hapat e ardhshëm.....	17
3 RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE	18
Shtojca 1: Matrica e raportimit për zbatimin e planit të veprimit të SBZHR 2022-2028.....	20

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Duke pasur parasysh rëndësinë dhe peshën e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural në bruto prodhimin vendor (BPV), si dhe potencialin e lartë të këtij sektori për t'u zhvilluar më tej dhe për të gjeneruar të ardhura dhe vende pune, mundë të themi që ky sektor padyshim zë një vend të rëndësishëm në zhvillimin e përgjithshme ekonomik të vendit. Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural duhet të kontribuojë në përdorim më të mirë të resurse në bujqësi dhe në të njëjtën kohë arrijtjen e një niveli më të lartë të konkurrueshmërisë së prodhimit agro-ushqimor. Procesi i anëtarësimit të Republikës së Kosovës në BE kërkon harmonizimin e rregulloreve dhe standardeve të bujqësisë dhe zhvillimit rural me rregulloret dhe standardet e Politikave të Përbashkët Bujqësore (PPB) të Bashkimit Evropian, kjo është një arsye e forte që Strategjia përmes veprimeve të për zgjedhura të kontribuoj në këtë drejtim.

Strategjia për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për periudhën 2022-2028 pasqyron nevojën për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe zonave rurale, për të konkurruar në tregjet e Bashkimit Evropian dhe tregjet rajonale. Identifikon masat për rritjen e efikasitetit të prodhimit, përpunimit dhe marketingut bujqësor; ndërtimin e institucione të duhura, efektive publike dhe private; për të përmirësuar të ardhurat e fermave; për të siguruar që konsumatorët të kenë qasje në ushqim të sigurt dhe të shëndetshëm; për të optimizuar përdorimin e burimeve të tokës, pyjeve dhe ujit, në mënyrë të qëndrueshme dhe miqësore ndaj mjedisore; dhe për të ndërtuar komunitete rurale të qëndrueshme përmes zhvillimit të qëndrueshëm rural.

Sipas analizave të përmbledhura janë identifikua objektivat strategjike dhe specifike, të cilat janë:

OS 1: Rritja e konkurrencës së sektorit agro-ushqimor dhe përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit të fermës

O. specifik 1.1: Mbështetje të ardhura të qëndrueshme të fermës dhe elasticiteti për të rritur sigurinë ushqimore
O. specifik 1.2: Rritja e konkurrencës dhe përmirësimi i orientimit ndaj kërkesave të tregut duke u fokusuar në kërkime, inovacion, teknologji dhe dixhitalizim
O. specifik 1.3: Përmirësimi i pozitës së fermerëve në zinxhirin e vlerës

OS 2: Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore (tokat, pyjet dhe uji)

O. specifik 2.1: Mbështetje në zbutjen dhe në përshtatjen me ndryshimet klimatike, si përdorimin e energjisë së ripërtëritshme
O. specifik 2.2 Mbështetje në nxitjen e menaxhimit të qëndrueshëm dhe efikas të tokës, ujit dhe
O. specifik 2.3 Mbështetje në mbrojtjen e bio-diversitetit, shërbimet e zgjeruara të ekosistemit dhe ruajtja e habitateve dhe peizazheve

OS 3: Zhvillimi i bizneseve në zonat rurale, rritja e punësimit dhe përmirësimin i infrastrukturës sociale

O. specifik 3.1: Promovimi i punësimit, rritjes, përfshirjes sociale dhe zhvillimit lokal në zonat rurale, përfshirë bio-ekonominë dhe zhvillimi i qëndrueshme i pylltarisë
O. specifik 3.2: Përmirësimi i kërkesave shoqërore për ushqimin dhe shëndetin, përfshirë ushqimin e sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm, zvogëlimin e mbeturinave të ushqimit, si dhe mirëqenien e kafshëve
O. specifik 3.4: Promovimi i barazisë gjinore, duke përfshirë pjesëmarrjen e grave në bujqësi dhe përfshirjen sociale të komuniteteve dhe grupeve të cenushme

OS 4: Reforma gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale për të krijuar shërbime publike efikase

O. Specifik 4.1 Riorganizimi dhe funksionalizimi i plotë i AZHB-së si Agjenci IPARD
O. Specifik 4.2 Arrija e besueshmërisë për menaxhim dhe zbatim të buxhetit për masat e programi IPARD III
O. Specifik horizontal 4.3: Dixhitalizimi i sektorit dhe transferimi i njohurive

Zbatimi i SBZHR 2022-28 bëhet nga dy lloje të masave të politikës: Shtylla I (pagesa direkte/subvencionet), Shtylla II (grante - zhvillimi rural) të ngjashme me Politikën e Përbashkëta Bujqësore (PPB) të BE-s, dhe nga projekte kapitale ose infrastrukturore dhe reforma institucionale që synojnë ta funksionalizojnë më tej Ministrinë drejt një administrate publike më efektive.

Veprimet e identifikuara për të arritur përmbushjen e objektivave strategjike dhe specifike trajtojnë çështje të sigurimit dhe sigurisë së ushqimit, përmirësimin e të ushqyerit dhe promovimin e bujqësisë së qëndrueshme, ruajtjen e resurseve natyrore, barazisë gjinore gjithëpërfshirëse, punësimi të plotë dhe produktiv, si dhe promovimin e mirëqenies edhe çështjet socio-ekonomike të zonave rurale.

Sipërfaqja e përgjithshme dhe shfrytëzimi i tokës bujqësore


Toka bujqësore është baza e prodhimit të bujqësore e cila siguron pjesën më të madhe të furnizimit me ushqim dhe siguron një numër kritik të shërbimeve të ekosistemit (për sigurimin e ushqimit). Prandaj, bujqësia është jetike për sigurinë ushqimore dhe mbështet Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG). Sipërfaqja e tokës bujqësore në Kosovë si resurs për të prodhuar ushqim për të plotësuar kërkesat e vetëmjaftueshmërisë është mjaft i kufizuar.

Sipërfaqja e përgjithshme e tokës në Kosovë është e ndarë në këto kategori: tokë bujqësore e cila merr pjesë me 38.53%, pyje dhe toka pyjore 44.11%, tokë urbane 4.40% dhe të tjera 12.96%.

Sipas të dhënave të anketës bujqësore, sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore nuk ka pasur ndryshime të mëdha dhe ka qenë një trend i përafërt i shfrytëzimit për këtë periudhë kohore.

Shfrytëzimi i tokës bujqësore në vitin 2020 sipas kategorive ka këtë shpërndarje: Livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët) me pjesëmarrje prej 52%, tokë e punueshme-ara përfshi perime (në fushë të hapur 8,491 ha dhe serra si kulturë e parë 562) 45%, kopshte dhe fidanishte 2%, Plantacione të pemëve 2% si dhe Plantacione të vreshtave 1%.

Fig. 1 Sipërfaqja e përgjithshme dhe shfrytëzimi i tokës bujqësore



Burime: Raporti i gjelbër

Plani i Veprimit të SBZHR është miratuar në Qeveri sipas që buxhetit të aprovuar paraprak d.m.th. KASH 2022- 24. Qeveria nuk ka ndare buxhet për adresimin e të gjitha nevojave të identifikuar për arritjen e objektivave.

Megjithatë për shkak të krizës globale të furnizimit me ushqim si pasojë e COVID 19, luftës në Ukrainë që ka ndikuar në rritjen e çmimeve të inputeve bujqësore, të cilat mesatarisht janë rritur prej 100%, deri në 300% Qeveria me vendim ka ndare buxhet shtese për kategorinë e subvencioneve.

Tabela 1 Shpenzimi i buxhetit sipas kategorive për vitin 2022

Kategoritë	Buxheti i aprovuar /2022	Buxheti i shpenzuar /2022	% e buxhetit të aprovuar
Paga dhe mëditje	3,045,778.00	2,458,723.80	80.73%
Mallra dhe shërbime	3,022,075.11	2,404,100.42	79.55%
Shpenzimet komunale	135,660.00	56,366.96	41.55%
Subvencione dhe grante	76,061,692.20	70,262,986.50	92.38%
Projekte kapitale	2,536,744.00	2,075,193.43	81.81%
GJITHSEJ	84,801,949.31	77,257,371.11	91.10%

Burimi:MBPZHR

Nga të katër objektivat strategjike të lartpërmendura: Objektivin strategjik 1 - Rritja e konkurrencës së sektorit agro-ushqimor dhe përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit të fermës. Veprimet e ndërmarra nga ky objektivi kanë absorbuar pjesën më të madhe të buxhetit.


Nga kategoria e pagesave direkte/subvencioneve dhe granteve, buxheti i aprovuar ishte 76,061,692.20 €, nga të cilat janë shpenzuar 70,262,986€ ose 92% dhe kanë përfituruar 28,222 fermer, subvencione dhe grante/ projekte të zhvillimit rural.

Nëse analizohen veprimet që janë realizuar nga kategoria subvencione / pagesa direkte do të shohim që ka realizim mbi 100%, kjo për shkak që Qeveria me vendim, ka ndare +18,000,000 m/€: për kultura bujqësore/ha/ prodhim, për koka kafshe dhe kualitet të qumështit.

Sa i përket ngecjeve në realizimit të veprimeve, ngecje ka pasur në zbatimin e projekteve infrastrukturore ose projekteve kapitale dhe shërbimeve. Po thuaj asnjë veprim që është planifikuar të zbatohet përmes prokurimit publik nuk është realizuar.

Gjithashtu duhet cekur që ka pasur ngecje edhe në veprimet të cilat kanë qene të planifikuara të zbatohen përmes financimit nga Donatoreve. Planifikimi i donatorëve shpesh nuk korrespondon me vitin e planifikimit dhe ndarjes buxhetore që në bëjmë. P.sh. projektet e financuara nga IPA 2021 që sipas projeksioneve tona është dashtë të fillojnë zbatimin në vitin 2022 ende nuk kanë filluar të zbatohen

Figura 2: Shpenzimi i buxhetit sipas kategorive ne vitin 2022



Burimi MBPZHR

2. PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE

2.1 PROGRES KUNDREJT OBJEKTIVIT

2.1.1 *Objektivi strategjik 1: Rritja e konkurrencës së sektorit agro-ushqimor dhe përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit të fermës*

Objektivi specifik 1.1: Mbështetje për të ardhura të qëndrueshme të fermës dhe fleksibiliteti për të rritur sigurinë ushqimore

Për të rritur sigurinë ushqimore dhe qëndrueshmërinë e fermës janë ndërmarrë këto aktivitete:

Veprimi 1.1.1 – Kompensimi i dëmeve ne bujqësi te shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ne 24 komuna te Kosovës. Komisioni ka shqyrtuar të gjitha aplikacionet (1,584 aplikacione, nga 24 komuna, ne vlere prej: 5,674,729.56 €), mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në manual ka aprovuar: 1,012 kërkesa në vlerë prej: 3,446,907.38 €, ku nga kjo vlere janë kompensuar 82% ose 2,826,464.05 €.

Veprimi 1.1.2 – subvencionimi i skemës se sigurimeve bujqësore (kultura bujqësore dhe kafshë) Gjithsejtë kane përfituar 9 fermer, në vlerë prej: 1,775.01€. Subvencionimi i primit është bere për kulturat bujqësore: mjedër, mollë, kumbull, rrush, dredhëz, spec, arrë, fasules, misrit, qershisë, vishnjës dhe dardhës. Edhe pse këtij procesi i ka paraprirë një fushate senzibilizuese /informuese nga DSHKT ne bashkëpunim me IFC, ne te gjitha regjionet e Kosovës, prapë mbete numër i vogël i fermerëve te interesuar për te aplikuar për këtë mase. Vlerësimet fillestare brenda Ministrisë tregojnë qe interesim i vogël për blerjen e policave te sigurimeve është për shkak te qe ekziston edhe një skemë paralele e mbulimit te dëmeve nga fatkeqësitë natyrore e cila ka me pak procedura administrative për tu kompensuar për këtë arsye është me tërheqëse për fermerët.

Veprimi 1.1.3 - Subvencionimi i fermerëve për kultura bujqësore për sipërfaqe/njësi dhe sasi të prodhimit për ha. Ne total për te gjitha këto kategori kane përfituar gjithsejtë 42,508 fermerë /përfitues. Për drithëra janë gjithsejtë 27,636 fermer përfitues respektivisht 88,660.57 ha dhe janë subvencionuar shtese 60,866,295 kg drithëra te prodhuara sipas kuotës.

Subvencionimi i prodhimit te lulediellit, kanë përfituar 4 fermer prodhues te lule diellit te cilët gjithsejtë kane kultivuar 45.5 ha.

Prodhimi i rrushit është subvencionuar për ha dhe për litër te vërës se prodhuar. Janë gjithsejte 2,711 fermer përfitues përkatësisht 2,723.45 ha vreshta dhe 7,702,215.45 l vere te prodhuar.

Nga subvencionimi i prodhimit te pemëve, ne total kane përfituar 4,293 fermerë ose 5,012.62 ha. Për prodhim te mjedrës kanë përfituar 376 fermer, respektivisht janë subvencionuar 1,150,071.22 kg mjedër te prodhuar. Ne prodhimin e pemëve kane përfituar 7,416 fermerë prodhues respektivisht 7,012.54 ha peme. Është subvencionuar edhe prodhimi i materialit fidanor nga kjo kategori kane përfituar 18 fermerë përfitues ose 592,448 ha material fidanor. Subvencionimi i bimëve aromatike mjekësore është bere për ha nga kane përfituar 54 fermer përfituese ose 38.89 ha

Veprimi 1.1.4 - Subvencionimi i fermave blegtorale për krerë te kafshëve, janë mbështetur 10,473 fermerë , ne vlerë prej: 12,689,808.94 €. Për subvencionimi për krerë kafshe kane përfituar 5,590 fermer, respektivisht 52,538 krerë lopë qumësht, dele 1,114 fermer përfitues, respektivisht 128,194.00, krerë dhi 249 përfitues/13,543 krerë dhi. blete 3,015 përfitues/ 190,204 koshere bletë. Dosa 116 përfitues, respektivisht 895 krerë, pula 72 përfitues respektivisht 868,909 koke pule. Akuakulture ose prodhim i peshkut 5 përfitues respektivisht 316,367.18 kg, krerë vica 304 përfitues respektivisht 4,565 krerë viça dhe subvencionimi për therje 8 përfitues ose 337 krerë për therje.

Veprimi 1.1.5 - Forcimi i shërbimeve këshilluese dhe përfshirja e inovacionit si pjesa thelbësore e transferimit të njohurive

Ky veprim nuk është realizuar përmes projektit te planifikuat qe është dashtë kontraktohet. Temat e Referencës për projekte janë përgatitë dhe dorëzuar me kohë, megjithatë procedurat e prokurimit kane zgjatur pasi ka pasur ankesa në OSHP dhe pas marrjes së vendimit nga OSHP-ja kontrata tani është në fazën e nënshkrimit për tu realizuar ne vitin 2013

Me gjithë atë DSHKT-ja edhe pa projekt ka zhvilluar aktivitetet dhe ka dhënë këshilla fermerëve përmes QIK-ve ku gjatë viti 2022 gjithsejtë 5683 fermerë janë përkrahur me këshilla teknike ne zyre dhe 1813 fermerë me këshilla direke, gjate vizitave ne ferma (këto të dhëna janë nga raportet e dërguara nga këshilltaret komunal të QIK-ve).


Tabela 2. Zbatimi i objektivi specifik 1.1

Veprimet	Buxheti i planifikuar	Buxheti i shpenzuar	% e realizimit
V.1.1.1	3,000,000.00	2,826,464.05	94.22%
V.1.1.2	50,000.00	1,775.01	3.55 %
V. 1.1.3	17,342,780.00	41,534,771.96	100%+139 %

V. 1.1.4	11,807,220.00	12,689,808.94	100+7%
V.1.1. 5	340,000.00	150,000.00	44,12%

Ashtu sipas përshkrimit të më lartë dhe prezantimit të buxhetit në tab.1 për aktivitetin 1.1.3 ka rritje të buxhetit +139% dhe +7 % për Aktivitetin 1.1.4. Arsye e rritjes së buxhetit për këto aktivitete ka të bëjë me krizën e sigurisë ushqimore si pasojë e COVID dhe luftës në Ukrainë

Figura 3. Zbatimi i objektivit specifik 1.1



Objektivi specifik 1.2: Rritja e konkurrencës dhe përmirësimi i orientimit ndaj kërkesave të tregut duke u fokusuar në kërkime, inovacion, teknologji dhe digjitalizim

Veprimi 1.2.1 Investime në përmirësimin e infrastrukturës fizike në sektorin e bujqësisë, përmes Masës 1: Investime në asetet fizike të fermave bujqësore. Nga kjo masë janë financuar 369 përfitues me vlerë totale: 19,447,485.74 €.

Në sektorin e pemëve janë financuar 94 projekte, në sektorin e perimeve janë financuar 134, për depo për ruajtje dhe grumbullim janë financuar 33 projekte, në sektorin e rrushit/ vreshta janë financuar 16 projekte dhe 92 projekte në sektorin e blegtorisë

Veprimi 1.2.2 Investime në përmirësimin e infrastrukturës fizike në sektorin e agro-perpunimit, përmes Masës 3: Investime në asetet fizike për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore. Nga kjo masë janë financuar 6 përfitues/ projekte, në vlerë prej 998,418.40 €. në këta sektorë: përpunues i qumështit (1), përpunues të mishit (2), përpunues të pemëve- perime,2) dhe pika grumbulluese-depo (1).

Veprimi 1.2.3 Përgatitja e studimeve të fizibilitetit dhe dizajnit të projekteve teknike për rehabilitimin dhe modernizimin. Ky veprim nuk është realizuar në mungesë të

mjeteve financiare. MBPZHR ka kërkuar buxhet te veçante për realizim të këtij projekti (veprim), mirëpo nuk është aprovuar kërkesa për ndarje te mjeteve përmes KASH.

Veprimi 1.2.4 Investime kapitalet për rehabilitimin, modernizimin dhe zgjerimin e sistemeve të ujitjes dhe te kullimit/drenazhit.

Ky veprim konsiderohet i kryer 50% pasi qe ne vitin 2022 janë nënshkruar tetë marrëveshje te bashkëpunimit për ndërtimin, rehabilitimin dhe zgjerimin e sistemeve te ujitjes ne tete komuna te Republikës se Kosovës (Mitrovicë, Vushtri, Kamenicë, Shtime, Klinë, Istog, Deqan dhe Junik).

Gjate vitit 2023 do te zbatohen këto projekte te ujitjes, përmes kompanive kontraktuesve me te cilat Ministria ka lidhur kontrata dhe se shpejti pritet fillimi- realizimi i këtyre tete projekteve. Ne vitin 2020-2022 është përfunduar Projekti: Rehabilitimi dhe modernizimi i sistemit te ujitjes ne KRU Radoniqi-Dukagjini(konsiderohen qe janë Rehabilituar 5500/ha-, por sipërfaqe te reja janë aftësuar rrethe 300/ha)

Veprimi 1.2.7 Skema e subvencionimit te cilësisë së qumështit, janë subvencionuar 1,138 përfitues, ne vlere prej: 1,492,060.53

Veprimi 1.2.8 LIGJIT NR.08/L-087 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr.04/L-040 PËR RREGULLIMIN E TOKËS, gjate vitit 2022 është hartuar dhe miratuar ne Qeveri Koncept Dokumenti për Rregullim te Tokës, ndërsa hartimi i Ligji për Rregullim të Tokës është i parapare te hartohet ne vitin 2024.


Tabela 3. Zbatimi i objektivit specifik 1.2:

Veprimi	Buxheti i planifikuar	Buxheti i shpenzuar	% e shpenzuar
V.1.2.1	11,595,324.00	19,447,485.74	100%+59.6%
V.1.2.2	5,000,000.00	998,418.40	19.9%
V. 1.2.3	500,000.00	0	0%
V.1.2.4	1,920,000.00	0	0%
V.1.2.6	0.00	00	0%
V.1.2.7	2,050,000.00	1,492,060.53	72%
V.1.2.8	00	00	100%

Veprimin 1.2.1/Masa 1. Investime ne përmirësimin e infrastrukturës fizike ne sektorin e bujqësie. Është një nder masat kryesore te investimeve ne sektorin e prodhimtarisë primare (pemëve, perimeve (përfshi pataten) dhe rrushit , blegtori (prodhim i qumështit, mishit, vezëve). Përmes këtij veprimi gjithashtu investohet ne rritjen e cilësisë dhe sigurisë me qëllim të përmbushjes së standardeve përkatëse kombëtare dhe të atyre të BE-së; mekanizem modern dhe dixhitalizimi i fermës; investimeve në teknologji për ruajtjen përfshirë kapacitetet për ftohje, klasifikim dhe paketim; si dhe ne energjinë e ripërtrishme. Buxheti per kete veprim eshte rrite per

+ 59.60 si rezultat i riallokimit te buxhetit nga masat e tjera te cilat nuk kanë mund ta absorbojnë buxhetin e alokaur

Figura 4. Zbatimi i objektivi specifik 1.2:



Burimi: MBPZHR

Objektivi specifik 1.3: Përmirësimi i pozitës së fermerëve në zinxhirin e vlerës

Veprimi 1.3.1 Ligji për Organizimin e Tregut të Përbashkët të produkteve bujqësore. Ligji për Organizimin e Tregut të produkteve bujqësore, ka përfunduar në dhjetor të vitit 2022 dhe është miratuar në Qeveri me datë 22.02.2023.

Grupet e prodhuesve të krijuara me këtë ligje do të ndihmojnë fermerët të përballen së bashku me sfidat e tregut dhe të forcojnë fuqinë e tyre negociuese në lidhje me prodhimin dhe marketingun, duke përfshirë edhe tregjet lokale, prandaj kjo masë ndikon në përmirësimin e pozitës së fermerëve në zinxhirin e vlerës.

2.1.2 Objektivi Strategjik 2: Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore

Objektivi specifik 2.1: Mbështetje në zbutjen dhe në përshtatjen në ndryshime klimatike, si dhe energjinë e ripërtëritshme

Veprimi 2.1.1 Investime në instalimin e paneleve solar për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme në fermat bujqësore dhe industrinë e agro- përpunimit nga buxheti M 1 dhe M3.

Nga buxheti i Masës 1 "Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore" 5% ose 972,374 euro janë investuar në prodhimin e energjisë së ripërtëritshme, nga kjo kanë përfituar 160 fermer.

Nga buxheti i Masa 3: Investimet në industrinë e agro -përpunimit" 5 % ose 50,000 euro janë investuar në prodhimin e energjisë së ripërtëritshme, nga kjo kanë përfituar 160 fermer dhe 6 agro-përpunues. Kapacitetet instaluese të sistemit të energjisë së ripërtëritshme/solare janë (697.20 kw)

Veprimi 2.1.3 Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura, në vitin 2022 janë pyllëzuar 111.04 ha me një buxhet prej 142,226.77 €

Veprimi 2.1.4 Hartimi i planeve menaxhuese.


Në vitin 2022 janë hartuar Planet Menaxhuese Afatgjata Pyjore për Njësitë Menaxhuese që përfshijnë gjithsejtë 36, 841.15 hektar ne vlere prej 232,749.94 €

Tabela 4. Zbatimi i objektivi specifik 2.1

Veprimi	Buxheti i aprovuar	Buxheti i shpenzuar	% e buxhetit te shpenzuar
V 2.1.2	1,022,295.20	1,022,295.20	100%
V 2.1.3	320,000	142,226.77	44,44%
V 2.1.4	250,000	232,739.94	93%

Nga përshkrimi i veprimeve dhe qasja e kërkesave te kryqëzuara për te prioritizuar projektet qe kane ndikim ne ndryshimet klimatike janë prodhuar janë instaluar sisteme te energjisë se ripertritshme me kapacitet prej 697.20 kw.

Figura 5. Zbatimi i objektivi specifik 2.1



Objektivi specifik 2.2: Mbështetje në nxitjen e menaxhimit të qëndrueshëm dhe efikas të tokës, ujit dhe ajrit

Veprimi 2.2.3 Prioritizimi i granteve për fermerët me investime në depot e plehut për menaxhimin e plehut organik.

Nga buxheti i masës 1 " Investime në asetet fizike të ekonomive bujqësore ", 10 % ose 1,022,295.20 euro janë dedikuar ne ndërtimin e depove për menaxhimin e plehut organik. Nga kjo mase 120 ferma kane përfituar për ndërtimin e depove për menaxhim te plehut organik:

- Depo për menaxhim të plehut në stallat e lopëve për prodhim të qumështit;
- Depo për menaxhim të plehut për stalla për viça dhe
- Depo për menaxhim të plehut në stalla për derra.

Objektivi specifik 2.3: Mbështetje në mbrojtjen e biodiversitetit, shërbimet e zgjeruara të ekosistemit dhe ruajtja e habitateve dhe peizazheve

Nuk ka pas verime të planifikuara për vitin 2022

2.1.3 Objektivi Strategjik 3: Mbështetje për bizneset në zonat rurale, rritjen e punësimit dhe përmirësimin e infrastrukturës sociale

Objektivi specifik 3.1: Promovimi i punësimit, rritjes, përfshirjes sociale dhe zhvillimit lokal në zonat rurale, përfshirë bio-ekonominë dhe zhvillimi i qëndrueshëm i pylltarisë

Veprimi 3.1.1 Grantet për diversifikimin e njësive lokale ushqimore dhe zinxhirit të furnizimit të shkurtër dhe për bizneset rurale jo-bujqësore. Janë financuar gjithsejtë 96 projekte në fushën e bizneseve në zonat rurale. Buxheti për këtë veprim është 2,999.644.01€.

Veprimi 3.1.2 Mbështetja e iniciativave të zhvillimit lokal rural përmes mbështetjes së GLV. Për përgatitjen e Strategjive të Zhvillimit Lokale


Masa 5 “Përgatitja dhe zbatimi i Strategjive Zhvillimore Lokale (SZhL) janë investuar 200,000 euro dhe kanë përfitua 6 GLV.

Tabela 5. Zbatimi i objektivi specifik 3.1

Veprimet	Buxheti i aprovuar	Buxheti i shpenzuar	% e buxhetit të shpenzuar
V 3.1.1	5,000,000.00	2,999,644.01	59.99%
V 3.1.2	200,000.00	59,695.00	29,85%
V 3.1.3	350,000	0.00	0.00

Burimi: MBPZHR

Figura 6. Zbatimi i objektivi specifik 3.1



Objektivi specifik 3.2: Përmirësimi i kërkesave shoqërore për ushqimin dhe shëndetin, përfshirë ushqimin e sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm, zvogëlimin e mbeturinave të ushqimit, si dhe mirëqenien e kafshëve


Veprimi 3.2.1 Bujqësia organike – subvencionimi/kompensuese për fermerët që zbatojnë rregullat e bujqësisë organike janë mbështetur 10 përfitues, me sipërfaqe prej 197.64 ha ne vlere prej 89,469€.

Veprimi 3.2.2 Prioritizimi i granteve për fermerët me investime në standardet e mirëqenies së kafshëve, duke stimuluar kështu reduktimin e përdorimit të antimikrobikëve veterinarë. 25% i buxhetit të Masës 1 “Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore” (3,409,273.92) është dedikuar për përmirësimin e mirëqenies së kafshëve, 59 fermer kanë investuar në përmirësimin e mirëqenies së kafshëve.

Tabela 5. Zbatimi i objektivit specifik 3.2

Veprimet	Buxheti i aprovuar	Buxheti i shpenzuar	% e buxhetit të shpenzuar
V 3.2.1	100,000.00	89,469.00	89.47%
V3.2.2	3,409,273.92	3,409,273.92	100%

Figura 7. Zbatimi i objektivit specifik 3.2



Objektivi specifik 3.4: Promovimi i barazisë gjinore, duke përfshirë pjesëmarrjen e grave në bujqësi dhe përfshirjen sociale të komuniteteve dhe grupeve të cenueshme

Fermerët gra dhe fermerët e rinjë promovohen dhe nxiten përmes dhënies së pikëve shtese në konkurrencën me fermerët tjerë gjithashtu për fermerët e rinjë ju ipen 5% më shumë mbështetje publike. Nga zbatimi i Programit të Zhvillimit Rural 2022 kanë përfituar 138 gra ose 31% në masat si në vijim:

Masa 1: Investimet në asete fizike të ekonomive bujqësore 97 përfituese.

Masa 3: Investime në asetet fizike për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore 2 përfituese.


Masa 7: Diversifikimi dhe zhvillimi i bizneseve në zona rurale 39 përfituese.

Tabela 6. Zbatimi i objektivit specifik 3.4

Masat	Përfituesit e përgjithshëm	Numri i grave përfituese masave	%
Masa 1	369	97	26.28
Masa 2	6	2	33.33
Masa 3	96	39	40.62
Totali	471	138	100

Burimi MBPZHR

Figura 8. Zbatimi i objektivit specifik 3.4



2.1.4 Objektivi Strategjik 4: Reforma gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale për të krijuar shërbime publike efikase

Objektivi specifik 4.1 Arritja e besueshmërisë për menaxhim dhe zbatim të buxhetit për masat e programi IPARD III (Riorganizimi dhe funksionalizimi i plotë i AZHB-së si Agjenci IPARD)

Veprimi 4.1.1 Ngritja e kapaciteteve të Autoritetit Menaxhues, të njësisë së asistencës teknike për qaje në buxhetin IPARD III (duke lejuar MBPZHR të mbulojë kostot nga fondet e IPARD-it si menaxhimi i programit, monitorimi dhe vlerësimi dhe zbatimi drejt

Veprimi 4.1.2 Asistencë teknike dhe trajnime për harmonizimin e mëtejshëm me rregulloret dhe dispozitat teknike të kapitujve 11, 12 dhe 13 të BE

Gjate viti 2022 nuk është identifikuar ndonjë trajnim specifik për këtë qëllim përveç mësimin në punë, megjithatë ky veprim është i gjere dhe në vazhdimësi janë disa projekte të BE në vitet në vijim që do të adresojnë këtë veprim i cili është shumë i rëndësishëm për proceset që Kosovën e presin në vitet në vijim.

Veprimi 4.1.5 Prezantimi i praktikave të mira bujqësore dhe mjedisore, ky veprim është i ndërlidhur me veprimin 1.1.5 që nuk është realizuar për arsye të dështimit të prokurimit. Praktikave të mira bujqësore duhet të hartohen dhe të prezantohen dhe shërbimet këshillimore tek fermerët, për PMB duhet të hartohet një udhëzues i cili me pastaj ju shpërndahet fermerëve dhe në të njëjtën kohë organizohen trajnime për letë qëllim.

Veprimi 4.1.7 Përgatitja e hartave GIS të tokës/inventarit të tokës/ dheut. Ky veprim ka dështuar për shkak të dështimit të prokurimit

Veprimi 4.1.9 Fuqizimi i Departamentit të Shërbimeve Këshillimore. Në vitin 2022 ka pas një progres të avancuar pasi që gjatë këtij viti është përgatitur Plani Strategjik i shërbimeve këshillimore për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027, i mbështetur nga Caritas-it Gjerman), ku parashikohet avancimi i sistemi të shërbimit këshillimore dhe krijimi i 7 zyrave regjionale për shërbime këshillimore. Megjithatë ende mbete sfide numri i vogël i stafit të Departamentit

Veprimi 4.1.10 Forcimi i kontrollit të MBPZHR-së për licencat e lëshuara për BMA-të e egra dhe PPJD. Ky veprim është zbatuar plotësisht, pasi që sipas proceduarve dhe kriterëve për shfrytëzimin dhe grumbullim të prodhimeve jo drusore të malit (PPJD) dhe bimëve aromatike (BMA), Departamenti i Pylltarisë ka licencuar për grumbull shtate subjekte për shfrytëzimin dhe grumbullimin e këtyre prodhimeve në pyjeve.

Veprimi 4.1.11 Studim mbi potencialin turistik natyror dhe antropik dhe krijimi i një sistemi të regjistrimit për operatorët e turizmit rural

Është hartuar koncepti i dokumentit për turizëm rural i cili është miratuar në qeverinë e Kosovës me datë 28.12.2022 Nr.23/116.

Objektivi specifik 4.2: Digjitalizimi i sektorit dhe transferimi i njohurive dhe inovacionit

Veprimi 4.2.1 Dixhitalizimi i MBPZHR-së, dhe politika e të dhënave të hapura

Procedurat e Prokurimit janë zhvilluar në kohë lidhur me mbledhjen e të dhënave të Rrjetit të Kontabilitet në Fermë - FADN, mirëpo kontrata nuk është nënshkruar ende. Lidhur me mirëmbajtjen e Sistemit të Integruar Informativ Bujqësor procedurat e prokurimit për angazhimin e një programeri për mirëmbajtjen e sistemit kanë dështuar sepse nuk kanë aplikuar kandidatë, kërkesa është ri-përsëritur dhe është në procedurë. Vazhdimi i ri-përsëritjes së kërkesave deri në realizimin e plotë të tyre, sepse të dhënat janë të domosdoshme jo vetëm për procesin e digjitalizimit por edhe për zhvillimin e analizave për hartimin e politikave.

Veprimi 4.2.2 Përmirësimi i sistemit të IT-së, për Menaxhim të politikave. Këto projekte kane dështuar te zbatohen për shkak te procedurave te prokurimit. Ne këtë vite janë bere disa iniciatiave te cilat do te finalizohen ne vitin 2023, ne përkrahje te GIZ-it.

Veprimi 4.2.5 Transferimi i njohurive mbi Global GAP (për fermerët) dhe HACCP (për AVUK-un). Ne mungesë te mbështetjes buxhetore/teknike nga donatoret, ky aktivitet nuk është realizuar ne vitin 2022, ky aktivitet ndërlidhet edhe me veprimin 1.1.5 qe nuk është realizuar për arsye te dështimit te prokurimit. Megjithatë ky është veprim qe duhet vazhduar ne te cilin mund te kontribuojnë edhe donatoret. Duhet te punohet me shume ne mobilizimin e donatoreve dhe instrumenteve te ndryshme për ketë qellim.

Veprimi 4.2.6 Ngritja e kapaciteteve të Institutit Bujqësor të Kosovës për kontrollin fitosanitar të operatorët e biznesit ushqimor të mund të përmbushin standardet e BE-së për sigurinë ushqimore dhe të përmirësojnë konkurrencën e tyre.

Ky veprim nuk është realizuar për shkak te dështimit te prokurimit publik me kohe. Progresi i limituar mund te përshkruhet përmes pasi qe IBK vazhdon te përgatis raporteve laboratorike për AUV-in dhe palët tjera të interesit bazuar ne standarde.

Veprimi 4.2.8 Transferimi i njohurive nga vendet e tjera të BE-së për zbatimin e iniciativave lokale /GLV

Është bere krekës nga TAIEX qe te mundësohet një vizitë ne një vend i BE me qellim te shihen praktikat me te mira por nuk kem marre përgjigje nga TAIEX

Veprimi 4.2.9 Ngritja e rrjeti kombëtar rural. Pas vizitës ne Rumani e financuar nga TAIEX/ respektivisht ne Autoritetin Menaxhues dhe Rrjetin Rural Kombëtar, pas kthimit është përgatitë një plan ose “harte rrugore” për ta themeluar rrjetin Rural te Kosovës

2.2.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore, duke përdorur tregues dhe grafikë

2.2.2 Histori suksesit

Zbatimi i te gjitha pagesave për subvencione

2.2.3 Vlerësimin e sfidave, mangësive dhe pengesave

Jo te gjitha veprimet/ nevojat e identifikuar për arritje te objektivave janë pranuar për tu financuar nga MFPT. Edhe pse Strategjia është aprovuar ne Qeveri, MFPT nuk ka pranuar te financoj asnjë veprim qe ka kosto jashtë KASH 2022-24 prandaj kërkohet qe te rritet vëmendja ne sigurimin e buxhetit për realizimin e veprimeve qe qojnë ne arritjen e këtyre objektivave.

Të gjitha veprimet qe janë planifikuar te zbatohen përmes projekteve me prokurim; kapitale dhe mallra dhe shërbime nuk janë realizuar.

Shume nga veprimet qe janë planifikuar te mbështeten nga donatoret nuk janë realizuar këtë vite për shkak te vonesave ne fillimin e zbatimit te tyre.

2.2.4 Resurset buxhetore

- Buxhet i republikës se Kosovës;
- BE;
- Donatoret tjerë bilateral dhe
- Sektori privat.

2.2.5 Konkluzionet dhe rekomandimet për hapat e ardhshëm

Zgjerimi, rehabilitimi dhe modernizimi i sistemeve të ujitjes

Sot nuk mund te imagjinohet prodhimtaria bujqësore intensivë pa sistemin e ujitjes. Sistemi i ujitjes zvogëlon efektet negative, nga mungesat e te reshurave dhe ndikon drejtpërsëdrejti ne rritjen e prodhimitarisë dhe sigurimin e ushqimit për popullatën. Sistemet moderne te ujitjes përveç qe mundësojnë rritjen e prodhimitarisë bujqësore dhe blegtorale ndikojnë edhe ne menaxhimin dhe shfrytëzimin me efikas te përdorimit te ujit. Prandaj duhet shtuar vëmendja ne zbatimin e projekteve te ujitjes aq me shume qe për këtë veprim ka pas buxhet te ndare sipas KASH 2022-24

Kompensimi i dëmeve nga fatkeqësitë natyrore

Aktualisht është planifikuar një buxhet prej 3,000,000 euro për kompensim, i cili mbulon një pjesë të konsiderueshme të dëmeve të vlerësuara vjetore prej 1,000,000 deri në 3,000,000 euro. Ekspertët e analizës sektorial kane rekomanduar qe gradualisht te rritet financimi për sigurime bujqësore duke shkuar ne zvogëlimin e kompensimeve direktet te dëmeve nga fatkeqësitë natyrore. Ekspertët rekomandojnë zbatimin e një sistemi të tillë, pasi qe fermerët do te kenë siguri me te madhe të bëjnë investimet në fermat e tyre..

Zbatimi i masave te kushtëzuara (Cross-Cutting Measure)

Me qellim të rritjes së ndikimit të shumëfishtë të subvencioneve që aktualisht përbëjnë pjesën më të madhe të mbështetjes publike për fermer, ekspertet dhe po ashtu BE në raportin vjetor të progresit për sektorin e bujqësisë kanë rekomanduar zbatimin e subvencioneve me masa të kushtëzuara.

- Kushtëzim me futjen e racave blegtorale me prodhimtari të lartë, dhe varieteteve të fidanëve me potencial më të lartë të prodhimit me qëllim që plotësojnë standardet e cilësisë dhe garantojnë sigurimin e cilësisë;
- Kushtëzim duke u bazuar në numrin e hektarëve (të sipërfaqes bujqësore të shfrytëzuar/UAA) për respektimin e praktikave të mira bujqësore, duke përfshirë përmirësimet në ndërtesat dhe infrastrukturën e fermave;
- Kushtëzim me pagesat për prodhimin e të mirave publike, duke përfshirë adoptimin e praktikave për
 - kontrollin e përdorimit të plehrave kimike dhe mjeteve kimike për kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve;
 - ruajtja dhe krijimi i habitateve; dhe
 - të mbrojtë tokën nga erozioni i tokës, të gjitha të përcaktuara në një plan të miratuar të menaxhimit mjedisor.

Forcimi i shërbimeve këshillimore për fermer dhe biznese rurale

Është e rëndësishme që të forcohen Shërbimet Këshillimore të Fermave me qëllim që mbështetja publike e dhënë përmes garantëve dhe subvencioneve për fermerët të maksimizohet përmes përdorimit të teknologjive moderne dhe inovacionit. Buxhetit për grante dhe subvencione karshi buxhetit për shërbimet këshillimore ka diferencë të madhe proporcionale duke ditur që shërbimet këshillimore kanë ndikim të drejtpërdrejt në:

- Rritjen e konkurrencës së sektorit agro-ushqimor, për ta harmonizuar atë në mënyrë progresive me standardet e BE-së dhe për të përmirësuar efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e prodhimit në fermë, i cili do të sigurojë përgjigje më të mirë ndaj kërkesave të shoqërisë për ushqim të sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm;
- Lehtësimin e zhvillimit të biznesit, rritjen dhe punësimin në zonat rurale, të përmirësojë pozicionin e fermerëve në organizimin e prodhuesve dhe në zinxhirin e vlerës dhe të tërheqë fermerët e rinj; dhe
- të kontribuojë në zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe të nxisë menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

3. RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE

Rreziqet që janë hasura gjatë monitorimit të zbatimit të këtij dokumenti kanë të bëjnë me:

- kapacitetin institucional;
- kapacitetin financiar;
- partneritetin dhe angazhimin e institucioneve të tjera si dhe faktorët e tjerë të jashtëm që ndikojnë në nivelin e zbatimit të dokumentit strategjik.

Kapacitetin institucional

Një numër i madhe i veprimeve nuk janë realizuar për shkak të prokurimit publik. Për shkak të kapaciteteve të limituara proceduar e prokurimit nuk kanë mund të kryhen brenda afatit të caktuar.

Kapacitetin financiar

Strategjia është miratuar nga Qeveria e Kosovës, megjithatë MFPT nuk ka ndarë buxhet për zbatimin e veprimeve të reja që do të ndikonin në arritjen e objektivave, veprimet janë realizuar vetëm me buxhetin ekzistues. Veprimet e reja dhe inovative kanë mbetur të kërkuar mbështetje nga donatorët.

Partneriteti dhe angazhimin e institucioneve të tjera

Mungesë e kapaciteteve në mobilizimin e partnerëve të tjerë (donatorëve) dhe investues të ndryshëm për të financuar veprimet të cilat nuk janë financuar nga buxheti i Kosovës.

Njësitë administrative të MBPZHR dhe stafi politikë duhet të mobilizohet që të gjitha kërkesat dhe veprimet të jenë të ndërlidhura me SBZHR në mënyrë që në ky dokument të jete i zbatueshëm.

Pjesë integrale e raportit është edhe Matrica e raportimit për zbatimin e planit të veprimit të SBZHR 2022-2028 (Shtojca 1)

SHTOJCA 1:

Matrica e raportimit për zbatimin e Planit të veprimit të SBZHR 2022-2028

Objektivat/Veprimet	Afati i fundit	Buxheti (€) Planifikuar/ Shpenzuar 2022	Burimi i financimit	Përgjegjësi t për raportim	Produkti/Outputi	Referencë të dokumente ve	Progresi i zbatimit
Objektivi strategjik 1: Rritja e konkurrencës së sektorit agro-ushqimor dhe përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit të fermës							
Objektivi specifik 1.1: Mbështetje për të ardhura të qëndrueshme të fermës dhe elasticiteti për të rritur sigurinë ushqimore							
1.1.1 Kompensimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore	2022 TM4	3,000,000/ 2,826,464.05	Buxheti KP: 47600- DNB-SB	DPBT- Komisio ni i vlerësimi t te dëmeve	Komisioni ka aprovuar: 1,012 kërkesa nga 24 komuna, në vlerë prej: 3,446,907.38 €, ku nga kjo vlere janë kompensuar 82%.	KASH (Bazuar ne Vendimin e Qeverisë së Kosovës. (Nr. 30/112, datë 13.12.2022).	Progresi i plotë (94.5%)
1.1.2 Skemat e sigurimit në bujqësi (kultura bujqësore dhe kafshë) Nga buxheti i subvencioneve)	Vjetore , TM4	50,000 /1,775.01	Buxheti KP:40100 DPB-SB	DPBT, AZHB	Janë mbështetur 9 fermer / polisa te sigurimit nga fatkeqësitë natyrore. Këtij procesi i ka paraprirë një fushate sensibilizuese/informuese.	KASH PSO	Progresi i limituar. Ende nuk ka kërkesa te dëshiruara për sigurime ne bujqësi . Vetëm 3.5 % e buxhetit te shfrytëzuar)

1.1.3 Subvencionimi/ mbështetja e të ardhurave të fermave për kultura bujqësore për sipërfaqe/ njësi dhe sasi të prodhimit	Vjetore , TM4	17,342,780/ 41,534,771.96	Buxheti KP:40100 -SB	AZHB	42,508 përfitues për sipërfaqe/ha dhe kg nga prodhimtaria bimore: 27,636 përfitues/88,660.57 ha+60,866,295 kg drithëra. 4 përfitues/45.5 ha luledielli 2,711 përfitues/2,723.45 ha vreshta + 7,702,215.45 l vere. 4,293 përfitues/5,012.62 ha pemë. 376 përfitues/1,150,071.22 kg mjedër. 7,416 përfitues/7,012.54 ha peme. 18 përfitues/592,448 ha material fidanorë. 54 përfitues/38.89 ha bime mjekuese aromatike (BMA).	KASH PSO PRE	Progresi i plotë Ka pasur tejkallim te buxhetit te planifikuar, si rezultat i rritjes se numrit te aplikanteve/ sipë rfaqeve. Tejkallim i buxhetit: +139 %, me rishikim te buxheti është bere rialokimi i mjeteve.
1.1.4 Subvencionimi/ mbështetja e të ardhurave të fermave për kafshë (përveç skemës së cilësisë së qumështit)	Vjetore , Q4	11,807,220/ 12,689,808.94	Buxheti KP 40100-SB	AZHB	10,473 përfitues për krerë/l te kafshëve nga prodhimtaria blegtorale: 5,590 përfitues/ 52,538 krerë lopë + 23,736,643 l qumësht 3,015 përfitues/ 190,204 koshe bletë.	KASH PSO	Progresi i plotë Ka pasur tejkallim te buxheti te planifikuar si rezultat i rritjes se numrit te aplikanteve/kre rëve. Tejkallim i

					<p>1,114 përfitues/ 128,194.00 krerë dele. 249 përfitues/13,543 krerë dhi. 116 përfitues/895 krerë dosa. 72 përfitues/868,909 krerë pula. 5 përfitues/316,367.18 kg akuakulturë - peshk. 304 përfitues /4,565 krerë viça 8 përfitues/337 krerë për therje.</p>		<p>buxheti: +7 % me rishikim te buxheti është bere rialokimi i mjeteve.</p>
<p>1.1.5 Forcimi i shërbimeve këshilluese dhe përfshirja e inovacionit si pjesa thelbësore e transferimit të njohurive</p>	<p>Vjetore TM3</p>	<p>340,000/0.00</p>	<p>Buxheti KP:40400 -MSH</p>	<p>DSHKT</p>	<p>Edhe pse ka dështuar projekti i këshillimeve, DSHKT ka ofruar shërbim këshillimor për: 5,683 fermer me këshilla teknike përmes QIKK, janë publikuar 10 mesazhe për fermer, publikimi është bere përmes web faqes se MBPZHR-se. Sa i përket buxhetit te planifikuar ne vitin 2022 për projektin këshillues, nuk është shfrytëzuar për shkak te vonesave ne procedura te prokurimit/ tenderimit.</p>		<p>Nuk ka progres Kanë dështuar proceduarat e tenderimit, për kontraktimin e një kompani te përgjegjshme këshilluese.</p>

Objektivi specifik 1.2: Rritja e konkurrencës dhe përmirësimi i orientimit ndaj kërkesave të tregut duke u fokusuar në kërkime, inovacion, teknologji dhe dixhitalizim							
1.2.1 Grantet për investime: M 1 Investime në asetet fizike të fermave bujqësore	Vjetore	11,595,324 19,447,485.74	Buxheti KP: 40700- SB 40700/DPZH R:	AZHB	Janë mbështet 369 projekte/ përfitues, nga prodhuesit bujqësorë-blegtorale: 94/S. Pemëve 134/S. Perimeve 33/Depo 16/S. Rrushit 92/S. Blegtorisë	KASH PSO PRE	Progresi i plotë Tejkalim i buxhetit:+ 67.72%, me rishikimi të buxheti është bere rialokimi i mjeteve.
1.2.2 Grantet për investime : M 3: Investime në asetet fizike që kanë të bëjnë me përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit M3)	Vjetore	5,000,000/ 998,418.40	Buxheti KP: 40700: 40700 -SB	AZHB	Janë mbështet 6 projekte/ përfitues nga sektori i agroperpunimit 1/Qumësht, 2/Mish, 2/Pemë/Perime, 1/Pika grumbulluese-Depo	KASH PSO PRE	Progresi i plotë , Numri i aplikanteve të përgjegjshëm ka qene me i vogël ne raport me buxhetin e ndare. Vetëm 19.90 % e bushtit është shfrytëzuar.
1.2.3 Përgatitja e studimeve të fizibiliteti dhe dizajni i projekteve teknike për rehabilitimin, modernizimin dhe zgjerimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit	Vjetore	500,000	Buxheti i Kosovës KP:40100- Kapitale	DPBT	Ky veprim nuk është realizuar ne mungesë të mjeteve financiare. MBPZHR ka kërkuar buxhet të veçante për realizim të këtij projekti (veprimi), mirëpo nuk është aprovuar kërkesa	KASH PSO PRE	Nuk ka progres: 0 %.

					për ndarje te mjeteve përmes KASH-it.		
1.2.4 Investime kapitalet për rehabilitimin, modernizimin dhe zgjerimin e sistemeve të ujitjes dhe te kullimit/drenazhit	Vjetore	1,920,000	Buxheti i Kosovës KP:40100-Kapitale	DPBT	Ne vitin 2022 janë nënshkruar 8 Marrëveshje te Bashkëpunimit për Ndërtimin, rehabilitimin dhe zgjerimin e sistemeve te ujitjes ne 8 komuna te Republikës se Kosovës (Mitrovicë,Vushtri,Kamenicë,Shtime,Klinë,Istog,Dëçan dhe Junik).	KASH PSO PRE	Progres jo i plote Ne vitin 2020-2022 është përfunduar Projekti: Rehabilitimi dhe modernizimi i sistemit te ujitjes ne KRU Radoniqi-Dukagjini (janë rehabilituar 5500/ha, për sipërfaqe te reja janë funksionalizuar rrethe 300/ha).
1.2.6 Krijimi i skemës për subvencionim te interesat e kredive rurale	Vjetore	0.00	N:500,000 Donator	Buxheti KP nuk është identifikua Donatoret	Ky aktivitet ndërlidhet me mbështetje nga donatorët.	KASH	Nuk ka progres, ne mungesë te donacioneve.
1.2.7 Skema e cilësisë së qumështit - subvencionim për qumështin e dorëzuar në fabrikat e përpunimit ose qendrat grumbulluese sipas nivelit te cilësisë (cilësi më e lartë – nivel më i lartë i subvencionimit)	Vjetore	2,050,000/ 1,492,060.53	Buxheti KP:40100-SB	AZHB	Janë përkrahur: 1,138 përfitues.	KASH PSO	Progresi i plotë: 73 % e bushtit është shfrytëzuar.
1.2.8 Ligji për Rregullim të Tokës	2022 Q4	0.00	Buxheti KP:40100-P&M	DPBT	Miratimi i: LIGJIT NR.08/L-087 PËR NDRYSHIMIN DHE	PKZMSA PSO	Progresi i plotë: 100%

					<p>PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr.04/L-040 PËR RREGULLIMIN E TOKËS GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 28 / 30 GUSHT 2022, PRISHTINË.</p>		
Objektivi specifik 1. 3 - Përmirësimi i pozitës së fermerëve në zinxhirin e vlerës							
1.3.1 Ligji për Organizimin e Tregut të Përbashkët të produkteve bujqësore	2022 Q4	0.00	Buxheti	DPBT	Hartimi i Ligji për Organizimin e Tregut të produkteve bujqësore, ka përfunduar në dhjetor të vitit 2022 dhe është miratuar në Qeveri me datë 22.02.2023.	PKZMSA PSO	Progresi i plotë: 100%
Objektivi strategjik 2: Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore							
Objektivi specifik 2.1: Mbështetje në zbutjen dhe në përshtatjen me ndryshimet klimatike, si përdorimin e energjisë së ripërtitshme							
2.1.2 Prioritizimi i granteve për fermerët me investime në energjinë e rinovueshme 5% nga buxheti M1 dhe M3	Vjetore 2022	5% e totalit të 20,445,904.14 (M1 +M3)+ 1,022,295	Buxheti KP:40700 –SB	AZHB	160 ferma dhe 6 ndërmarrje të agro-perpunimit , kanë instaluar sisteme të energjisë së ripërtitshme/solare (697.20 kw të instaluar)	KASH PSO	Progresi i plotë: 100%
2.1.3 Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura	Vjetore 2022	320,000/142,226.77	Buxheti KP 40300-Kapit.	APK	Në vitin 2022 janë pyllëzuar gjithsej 111.04 hektarë. (Një llot i tenderit ka dështuar të	KASH PSO	Progresi i pjesshëm: 44.44% e bushtit

					zbatohet për shkak të procedurave të prokurimit).		është shfrytëzuar
2.1.4 Hartimi i planeve menaxhuese		250,000/232,739.94	Buxheti KP 40300-Kapit.	APK	36, 841, 15 ha	Plani Vjetor i Menaxhimit me Pyje për vitin 2022	Progresi i plotë: 93% e buxhetit është shfrytëzuar.
Objektivi specifik 2.2 : Nxitja e menaxhimit të qëndrueshëm dhe efikas të burimeve (toka, uji, ajri)							
2.2.3 Prioritizimi i granteve për fermerët me investime në depot e plehut për menaxhimin e plehut organik (Vjetore/pjesë e buxhetit për M1)	Vjetore	Pjese e buxhetit te masës 1 dhe 3 1,200.000	Buxheti KP: 40700-SB	MBPZHR, AZHB	120 përfitues kanë investuar ne depot për menaxhimin e plehut organi, nga masa 1.	KASH PSO	Progresi i plotë: 100%
Objektivi strategjik 3 - Zhvillimi i bizneseve të zonave rurale dhe rritja e punësimit dhe infrastrukturës sociale							
Objektivi specifik 3.1: Promovimi i punësimit, rritjes, përfshirjes sociale dhe zhvillimit lokal në zonat rurale, duke përfshirë ekonominë bio							
3.1.1 Grantet për diversifikimin e njësive lokale ushqimore dhe zinxhirëve të furnizimit të shkurtër dhe për bizneset rurale jo-bujqësore	Vjetore	5,000.00.00/2,999,644.01	Buxheti KP: 40700-SB	AZHB	Janë përkrahur 96 biznese rurale: 3/Grumbullimi dhe përpunimi i produkteve jo drusore të pyllit përfshirë bimët mjekësore dhe aromatike. 32/Zhvillimi i turizmi rural dhe agro – turizmi. 10/Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare. 35/Prodhimi mjaltit. 13/Aktivitetet jo-bujqësore në zona rurale. 1/Rritja e shpezëve të fshatit dhe	KASH PSO PRE	Progres jo i plotë, Numri i aplikanteve te përgjegjshëm ka qene me i vogël ne raport me buxhetin e ndare. 59.9% e buxhetit është shfrytëzuar.

					2/Kultivimi i peshkut.		
3.1.2 Mbështetja e iniciativave të zhvillimit lokal rural përmes mbështetjes së GLV	Vjetore	200,000/ 59,695.00	Buxheti KP: 40700-SB	AM ,AZHB	Kanë përfituar 6 GLV, për përgatitja e strategjive të zhvillimit lokal – Qasja LEADER.	KASH PSO PRE	Progres jo i plotë , kanë mbetur pa përfituar gjysma e GLV-e të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret. 29.8% e buxheti është shfrytëzuar.
3.1.3 Projekti për infrastrukturën publike rurale, rrugë e vreshtave në Komunën e Rahovecit	Vjetore	350,000	Buxheti KP: 45800-KP	DPBT - DVV	Aktivitet i planifikuar në vitin 2023.	KASH PSO	Nuk ka progres-
Objektivi specifik 3.2: Përmirësimi i kërkesave shoqërore për ushqimin dhe shëndetin, përfshirë ushqimin e sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm, zvogëlimin e mbeturinave të ushqimit, si dhe mirëqenien e kafshëve							
3.2.1 Bujqësia organike – subvencionimi / kompensuese për fermerët që zbatojnë rregullat e bujqësisë organike, pasi prodhimi i tyre është zakonisht më i ulët ndaj ndalimit të plehrave kimike dhe pesticideve	Vjetore	100,000/ 89,469	Buxheti KP: 40100-SB	MBPZHR, AZHB	Janë mbështetur: 10 përfitues/projekte, me sipërfaqe prej 197.64 ha	KASH PSO	Progresi i plotë: 89.40% e buxheti është shfrytëzuar.

3.2.2 Prioritizimi i granteve për fermerët me investime në standardet e mirëqenies së kafshëve, duke stimuluar kështu reduktimin e përdorimit të antimikrobikëve veterinarë (Vjetore pjesë e buxhetit për M1).	Vjetore	25% e buxhetit nga masa 1. 3,409,273.92	KP:40700-SB	AZHB	59 ferma blegtorale kane investuar ne mërquinjën kafshëve	KASH PSO	Progresi i plotë: 100%
Objektivi strategjik 4 - Reforma gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale për krijimin e shërbime publike më efikase							
Objektivi specifik 4.1 Arritja e besueshmërisë për menaxhim dhe zbatim të buxhetit për masat e programi IPARD III							
4.1.1 Ngritja e kapaciteteve te Autoritetit Menaxhues, te njësisë së asistencës teknike për qaje në buxhetin IPARD III (duke lejuar MBPZHR të mbulojë kostot nga fondet e IPARD-it si menaxhimi i programit, monitorimi dhe vlerësimi dhe zbatimi drejt besimit për menaxhim te buxhetit te IPARD III)	N/A	N: 24,000 Nacional	Buxheti KP:40700- MSH BE , IPA III TAIEX	AM Donatoret	Tre zyrtar te AM ne vizite studimore ne Rumani, ne Autoritetin Menaxhues te Rumanisë dhe ne Rrjetin Rural te Rumanisë	PSO PRE	Progres i limituar
4.1.2 Asistencë teknike dhe trajnime për harmonizimin e mëtejshëm me rregulloret dhe dispozitat teknike të kapitujve 11, 12 dhe 13 të BE	N/A	N: 100,000 Donatore	Buxheti KP:40700- MSH BE , IPA III TAIEX	Departame ntet e Ministrisë, AZHB dhe AUVK	Ky aktivitet ndërlidhen me mbështetje nga donatorët	MSA PSO PRE	Nuk ka progres, ne mungese te donacioneve.

4.1.5 Përgatitja e hartave GIS të tokës/inventarit të tokës/dheut		460,000.00	Buxheti KP: 40500 BE , IPA III TAIEX		Ky veprim ka dështuar për shkak të dështimit të prokurimit		
4.1.9 Fuqizimi i Departamentit të Shërbimeve Këshillimore	2022 Q2	0.00	Buxheti KP: 40400 MSH BE , IPA III TAIEX	DSHKT	Është përgatitë Plani Strategjik i shërbimeve këshillimore për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027, i mbështetur nga Caritas-it Gjerman), ku parashikohet avancimi i sistemi të shërbimit këshillimore dhe krijimi i 7 zyrave regjionale për shërbime këshillimore	KASH	Progres i limituar
4.1.10 Forcimi i kontrollit të MBPZHR-së për licencat e lëshuara për BMA-të e egra dhe PPJD	2022 Q3	0.00	Buxheti KP:40600-PM BE , IPA III TAIEX	DPBT/DP	Realizimi i Planit vjetor dhe plotësimi i kriterëve të licencimit		Progresi i plotë: 100%
4.1.11 Studim mbi potencialin turistik natyror dhe antropik dhe krijimi i një sistemi të regjistrimit për operatorët e turizmit rural	2022 Q3	0.00	Buxheti KP: 40700-MSH BE , IPA III TAIEX	MBPZHR / Donatorët	Është hartuar koncepti i dokumentit për turizëm rural cili është miratuar në qeverinë e Kosovës me datë 28.12.2022 Nr.23/116.		Progres i pjesshëm.
Objektivi specifik 4.2: Dixhitalizimi i sektorit dhe transferimi i njohurive dhe inovacionit							

4.2.1 Dixhitalizimi i MBPZHR-së, dhe politika e të dhënave të hapura	Vjetore	100,000/0.00	KP:47300-MSH	AZHB dhe DAESB	Këto projekte nuk janë zbatohen për shkak të dështimit të procedurave të prokurimit.		Nuk ka progres
4.2.2 Përmirësimi i sistemit të IT-së, për Menaxhim të politikave	2022	135,000/0.00	Buxheti KP:47400-KP Donatorët	AZHB	Këto projekte kane dështuar të zbatohen për shkak të procedurave të prokurimit. Ne këtë vite janë bere disa iniciatiave të cilat do të finalizohen ne vitin 2023, ne përkrahje të GIZ-it.	KASH PSO	Progres i limituar. Ne vitin 2023 pritet një avancim i sistemit të aplikimit dhe vlerësimit të projekteve të zhvillimit rural, ne përkrahje të donatoreve: GIZ-i Gjerman.
4.2.5 Transferimi i njohurive mbi Global GAP (për fermerët) dhe HACCP (për AVUK-un)	2022 Q4	0.00	TAIEX	MBPZHR /AVUK/ Donatorët	Ne mungesë të mbështetjes buxhetore/ teknike nga donatorët, ky aktivitet nuk është realizuar ne vitin 2022.		Nuk ka progres
4.2.6 Ngritja e kapaciteteve të Institutit Bujqësor të Kosovës për kontrollin fitosanitar të operatorët e biznesit ushqimor të mund të përmbushin standardet e BE-së për sigurinë ushqimore dhe të përmirësojnë konkurrencën e tyre	Vjetore	200,000/0.00	IBK	IBK BE-IPA	Këto projekte kane dështuar të zbatohen për shkak të procedurave të prokurimit. Progresi i limituar mund të përshkruhet përmes: Përgatitjes së raporteve laboratorike për AUV-in		Progres i limituar

					dhe palët tjera të interesit bazuar ne standarde		
4.2.8 Transferimi i njohurive nga vendet e tjera të BE-së për zbatimin e iniciativave lokale /GLV	2022 K2	0.00	TAIEX	MBPZH-AM Donatorët / TAIEX	Është bere krekës nga TAIEX qe te mundësohet një vizitë ne një vend i BE me qellim te shihen praktikat me te mira por nuk kem marre përgjigje nga TAIEX	TAIEX	Progres i limituar Ka munguar mbështetja nga donatoret ne transferim te njohurive.
4.2.9 Ngritja e rrjeti kombëtar rural	2022 Q4	N:100,000 Donatore	TAIEX	DPZHR/AM	Është përgatitë “road map” për themelimin e Rrjetit Rural		Progres i limituar Pas vizitës ne Rumani e financuar nga TAIEX/ respektivisht ne Autoritetin Menaxhues dhe Rrjetin Rural Kombëtar, pas kthimit është përgatitë një plan ose “harte rrugore” për ta themeluar rrjetin Rural te Kosovës